**KËRKESË**
**Nr. 206/8, datë 24.6.2024**

**PËR SHPRONËSIM DHE/OSE PËR SHKËMBIMIN E PRONËS PËR INTERES PUBLIK**

Agjencia Shtetërore për Shpronësimin shpall kërkesën "Për disa shtesa dhe ndryshime në VKM-në nr. 719, datë 13.12.2023, 'Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, në funksion të procesit të rindërtimit, në zonën e re për zhvillim, në Njësinë Administrative nr. 11, Universiteti Bujqësor i Tiranës, Bashkia Tiranë'".

Subjekti kërkues për këtë projekt është Bashkia Tiranë.

Me anë të këtij publikimi kërkojmë të vëmë në dijeni personat e prekur nga ky shpronësim dhe/ose shkëmbim, për interes publik, për pasuritë e paluajtshme, pronë private, të cilat do të kompensohen sipas vlerësimit paraprak të llogaritur si:

1. Sipërfaqja e prekur e shpronësimit për pasurinë nr. 1/136, ZK 8320, në pronësi të Nysret Haki Haxhija dhe Sait Fani, sipas VKM-së **ishte 2336 $m^2$, bëhet 2335 $m^2$**, dhe vlera **nga 53,692,960 lekë, bëhet 53,669,975 lekë** (me efekt zbritës për këtë pasuri).

Personat që preken nga ky projekt të cilët kanë emrin në tabelën e publikuar dhe personat të cilët preken por nuk figurojnë në këto lista, jo më vonë se 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga publikimi në Fletoren Zyrtare, kanë të drejtë të paraqesin pretendimet e tyre, të shoqëruara me dokumentet përkatëse pranë Bashkisë Tiranë dhe në Agjencinë Shtetërore për Shpronësimin.

Kërkesa për ndryshimin e VKM-së nr. 719, datë 13.12.2023, "Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, në funksion të procesit të rindërtimit, në zonën e re për zhvillim, në Njësinë Administrative nr. 11, Universiteti Bujqësor i Tiranës, Bashkia Tiranë" është me vlerë totale paraprake të kompensimit nga shpronësimi **53,669,975 lekë** (pesëdhjetë e tre milionë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e nëntë mijë e nëntëqind e shtatëdhjetë e pesë) lekë (me efekt zbritës për këtë pasuri).

DREJTOR I PËRGJITHSHËM
KRYETAR I KOMISIONIT TË POSAÇËM
TË SHPRONËSIMIT DHE/OSE SHKËMBIMIT
**Kastriot Gurra**

# LISTA EMËRORE PARAPRAKE E PRONARËVE QË SHPRONËSOHEN, "PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË VKM-në NR. 719, DATË 13.12.2023, 'PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, NË FUNKSION TË PROCESIT TË RINDËRTIMIT, NË ZONËN E RE PËR ZHVILLIM, NË NJËSINË ADMINISTRATIVE NR. 11, UNIVERSITETI BUJQËSOR I TIRANËS", BASHKIA TIRANË

| Nr. | Pronari | | | Të dhënat (mbi pasurinë sipas ASHK-së) | | | | vlerësimet për shpronësim dhe/ose kompensim sipas llojit të pasurisë | | | | | | | | | | Vlera në VKM-në nr. 719/2023 ishte | Vlera totale (lekë) bëhet | Konfirmuar/shënime | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | | | | Shpronësim tokë "truall" | | | Sip. e ndërtesës totali ($m^2$) | Ndërtesë banimi (shtëpi) | | | Ndërtesë jobanimi | | | | | | | |
| | Emri | Atësia | Mbiemri | ZK | Nr. i pas. | Lloji i pas. | Sip. totale truall/arë $m^2$ | Sip. e prekur ($m^2$) | Çmimi (lekë/$m^2$) | Vlera (lekë) | | Sip. e prekur ($m^2$) | Çmimi mesatar sh/blerjeve sipas ASHK-së (lekë/$m^2$) për banesë | Vlera (lekë) | Sip. e prekur ($m^2$) | Çmimi sipas kostos së ndërtimit nga EKB-ja (lekë/$m^2$) për jobanesë | Vlera (lekë) | | | Drejtoria Vendore Tirana Jug, e ASHK-së | Shënime në kartelë | Informacion i ardhur pranë Komisionit të Posaçëm të Shpronësimit nga Enti Kombëtar i Banesave (me *email*) |
| PRONË PRIVATE | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | |
| 1 | Nysret Sait | Haki | Haxhija Fani | 8320 | **1/136** | Truall | 2,335.0 | 2,335.0 | 22,985.0 | 53,669,975.00 | | | | | | | | 53,692,960.00 | 53,669,975.00 | Aplikimi 1330, datë 10.1.2024 | | |
| Totali paraprak | | | | | | | | **2,335.00** | | | | | | | | | | | **53,669,975.00** | | | |

**Shënime:**

1. Llogaritjet paraprake të pasurive të kësaj liste, janë bazuar në materialin e dërguar të ASHK Tirana Veri në përgjigje të aplikimit me nr. 1330, datë 10.1.2024.
2. Për vlerësimin e pasurive të llojit truall jemi referuar VKM-së nr. 89, datë 3.2.2016.
3. Çmimi i miratuar me vendim nga Enti Kombëtar i Banesave bazohet në udhëzimin nr. 3, datë 28.12.2016, të Këshillit të Ministrave, bashkëlidhur shkresës nr. 1644/1, datë 14.4.2021.